




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 53, paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2023, për Administratë të Hapur në Komunë, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e grupit punues për hartimin e Projektbuxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2025-2027

1. Caktohet Grupi punues për hartimin e Projektbuxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2025-2027, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ekrem Bytyqi - kryesues;
 - 1.2. Skender Hamza – anëtar, procesmbajtës;
 - 1.3. Ardian Rama - anëtar;
 - 1.4. Egzon Thaqi – anëtar, procesmbajtës;
 - 1.5. Izet Morina - anëtar;
 - 1.6. Muharem Morina - anëtar;
 - 1.7. Blerta Gashi – anëtare, moderatore e dëgjimeve;
 - 1.8. Albion Krasniqi – anëtar, procesmbajtës;
 - 1.9. Qëndresa Kryeziu – Hoxha – anëtare, procesmbajtëse;
 - 1.10. Mimoza Ejupi - anëtare;
 - 1.11. Bahrije Çmega - anëtare;
 - 1.12. Ardit Halilaj – anëtar, fotograf dhe procesmbajtës;
 - 1.13. Kosovare Gashi - anëtare;
 - 1.14. Agnesa Ramadani – anëtare.
2. Grupi punues ka për detyrë që të hartojë projektbuxhetin e Komunës së Rahovecit për vitin 2025-2027, ta bëjë hartimin e planit të brendshëm komunal për mbarëvajtjen e dëgjimeve buxhetore, ta bëjë përgatitjen e njoftimit për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, ta caktojë personin përgjegjës për mbajtjen e procesverbaleve gjatë mbajtjes së dëgjimeve buxhetore dhe ta bëjë hartimin e tij në afatin ligjor, që parashihi në Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, ta bëjë hartimin e raportit nga dëgjimet buxhetore dhe ta përgatisë për ta dërguar në Kuvendin Komunal.

3. Obligohet grupi punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe në aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Obligohet grupi punues që, të marrë pjesë në të gjitha dëgjimet buxhetore dhe pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe për Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesën anëtarët e grupit punues për hartimin e projektbuxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2025-2027.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr.Prot.02/ 99 /2023, i datës 1.2.2023, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimet me Nr. Prot. 02/725/2023, i datës 8.6.2023 dhe Nr.Prot. 02/3779/24, i datës 29.1.2024.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Anëtarëve të grupit punues, dhe***
- ***Arkivit.***

